



BiEPAG

Tetor 2023

**Gjeopolitika fillon
që në shtëpi:**

GJEOPOLITIKA FILLON QË NË SHTËPI: ROLI I AKTORËVE TË HUAJ NË SEKTORIN ENERGJETIK TË BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Autorë: Marika Djolai dhe Corina Stratulat.

** About the research project*

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (BiEPAG) po realizon një studim gjithëpërfshirës për gjeopolitikën e tranzicionit drejt energjisë së gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Ky dokument politikash mbështetjet në gjetjet e dokumentit të parë "Energjia në Ballkanin Perëndimor" (maj 2023) dhe në një sondazh të realizuar në nivel rajoni në Ballkanin Perëndimor, puna në terren e të cilit u krye në gjatë muajve mars-prill 2023. Gjetjet kryesore të këtij studimi bazohen në të dhënat e mbledhura nëpërmjet punës kërkimore dhe intervistave gjysmë të strukturuar të realizuara në muajt mars-qershor 2023 me gjashtë ekspertë të energjisë, mjedisit dhe burimeve natyrore si dhe me përfaqësues nga ministritë përkatëse dhe kompani të prodhimit të energjisë si dhe me përfaqësues të Komunitetit të Energjisë. Si rast studimor është zgjedhur qyteti i Tuzlës, ku ndodhet edhe termocentrali më i madh në Bosnje dhe Hercegovinë. Marika Djolai është pedagoge në Departamentin e Studimeve për Paqen dhe Zhvillimin Ndërkombëtar në Universitetin e Bradfordit. Corina Stratulat është Drejtore e Programit të Politikave dhe Institucioneve Evropiane në Qendrën e Politikave Evropiane.

Rekomandime për politikën

- > Bosnje dhe Hercegovina duhet të zbatojë kuadrin ligjor që rregullon çdo aspekt të procesit të tranzicionit të energjisë: energjinë e rinovueshme, ruajtjen e energjisë në bateri, hidrogjenin dhe hidrocentralet, përdorimin dhe ruajtjen e sekuestrimit të karbonit, tregtinë e karbonit, taksën e karbonit, automjetet elektrike, shpërndarjen/transmisionin e energjisë, efikasitetin e energjisë, qytetet inteligjente, mikro-rrjetet dhe projektet e gazit në energji, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së.
- > Bosnje dhe Hercegovina duhet të marrin më shumë presion dhe mbështetje financiare dhe ekspertizë nga procesi i integritetit për të arritur përputhshmërinë.
- > Për angazhimin e aktorëve të huaj, veçanërisht të Kinës, duhen mekanizma të konsoliduar kontrolli dhe verifikimit, masa ndëshkuese (p.sh., gjyko për ndotësit apo për shkelje kontrate) dhe harmonizim të kuadrit ligjor në të gjitha nivelet e qeverisjes, së bashku me diversifikimin strategjik të financave dhe kapitalit shtetëror.
- > Mbështetja për shoqërinë civile dhe mediat e pavarura është me rëndësi tejet të madhe. Këta aktorë luajnë një rol kyç në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Nga ana tjetër, ata mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit tek popullata në përgjithësi për sa i përket sfidave të ndryshme por edhe përgjegjësi të vetë njerëzve (p.sh., kursimin e energjisë elektrike, termoizolim të shtëpive dhe përdorimit të pompave me ngrohje), duke mobilizuar mbështetjen e publikut për reformat.
- > Investimet në shumë nivele në edukimin e publikut të gjerë për problemet mjedisore, klimatike dhe energjetike duhet të mbështeten me financime dhe planifikim strategjik nga BE dhe qeveria e Bosnje dhe Hercegovinës të paktën deri në vitin 2030. Kjo mbështetje duhet të ndërthuret me marrëveshje për ngrohje alternative dhe të qëndrueshme për të zbutur ndikimin e mundshëm të mbylljes së termocentraleve (TEC) në vend.

Abstrakt

Kornizat e ndërlikuara administrative dhe ligjore që i bënë të mundur korrupsionit dhe klientelizmit të lulëzojnë në Bosnje dhe Hercegovinë (BiH) i bëhen pengesë sektorit energjetik në vend për të ecur drejt nivelit zero të emetimeve deri në vitin 2050. Po ashtu, ky studim sugjeron se aktorët e huaj janë më shumë një simptomë sesa shkak i tranzicionit të ngadaltë energjetik të BiH. Motivimi i tyre kryesor është të mos ushtrojnë ndikim politik në BiH. Përkundrazi, ata vijnë në vend për shkak të bollëkut të burimeve natyrore, infrastrukturës së mirëzhvilluar dhe impianteve të prodhimit si dhe për të gjeneruar fitime. Ata nuk investojnë për të marrë përgjegjësinë për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore apo për prodhimin e energjisë, por thjesht për të siguruar koncesione dhe për të arkëtuar fitime sa më shumë dhe sa më shpejt para se të hidhen në një marrëveshje të re pa përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale. Qytetarët e BiH në ndërkohë mbeten të painformuar dhe mjerisht të pafuqishëm për të bërë diçka.

Metodologjia e hulumtimit

Për të hedhur dritë mbi veprimet dhe ndikimin e investimeve të huaja në sektorin energjetik dhe tranzicionin e BiH-së, autorët u mbështetën në shqyrtim literature dhe kërkimin në terren. Nxjerrja e të dhënave nga analizat shkencore, artikujt e gazetave, dokumentet dhe deklaratat zyrtare dhe raportet u plotësuan me informacionin e mbledhur nëpërmjet intervistave dhe takimeve me palët përkatëse të interesit.

U realizuan intervistat gjysmë të strukturuar me gjashtë ekspertë të energjisë, mjedisit dhe burimeve natyrore, si dhe me pesë përfaqësues nga ministritë përkatëse dhe kompanitë e energjisë. Qyteti i Tuzlës, ku ndodhet termocentrali më i madh në BiH, është përzgjedhur si rast studimi. Në 30 maj 2023 u organizua një tryezë njëditore ekspertësh me shtatë përfaqësues të shoqërisë civile në vend, gazetarë, aktivistë dhe ekspertë, të cilët shkëmbyen mendime për çështjet kryesore të këtij hulumtimi: Si sillen aktorët e huaj në sektorin energjetik të BiH? Dhe çfarë ndikimi kanë ata në tranzicionin e gjelbër të vendit?

Autorët përdorën edhe rezultatet nga sondazhi i kryer në kuadër të këtij projekti në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë muajve mars-prill 2023.



I. Mjedisi energjetik i Bosnjës dhe Hercegovinës

Energjia është një sektor kryesor ekonomik në Bosnje dhe Hercegovinë dhe një forcë e mundshme shtytëse për rritjen ekonomike të vendit. Burimet e bollshme hidroenergjetike dhe rezervat e qymyrit të BiH-së¹ i bëjnë të mundur vendit të prodhojë sasi të mëdha energjie elektrike, duke e bërë energjinë elektrike eksportin e saj kryesor.² BiH është i vetmi eksportues neto i energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor, duke u shitur mbi 50% të totalit të prodhuar fqinjëve të saj, Kroacisë dhe Serbisë.³ Për rrjedhojë, sektori i saj energjetik mbetet mjaft tërheqës për aktorët e huaj, veçanërisht Kinën, gjë që shpjegon angazhimin e vazhdueshëm të këtyre aktorëve me vendin. Megjithatë, sektori energjetik i BiH-së varet shumë nga qymyri. Rezervat e qymyrit të Bosnje dhe Hercegovinës renditen në vendin e njëzetë e pestë në botë për nga madhësia (0.2% e peshës globale). BiH përdor linjiten si lëndë djegëse kryesore për prodhimin e energjisë.

Në vitin 1995, pas Luftës së Bosnjës, sistemi energjetik në BiH u nda mes tre kompanive aksionere (me entet shtetërore si aksionerë kryesorë). Këtyre kompanive iu dha pushteti për të kontrolluar prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Kjo ndarje nuk kishte një arsyetim teknik, por pasqyronte strukturën e ndarjeve etno-politike të vendit. Kështu, kjo ndarje çoi në pabarazi të konsiderueshme të prodhimit të energjisë mes tre ndërmarrjeve publike: JP⁴ Elektroprivreda BiH (me qendër në Sarajevë), MH⁵ Elektroprivreda Republike Srpske (me qendër në Trebinjë) dhe JP Elektroprivreda Hrvatske zajednice Herceg Bosne (me qendër në Mostar).⁶

Varësia nga qymyri për ngrohjen e shtëpive dhe prodhimin e energjisë elektrike e vendos BiH mes vendeve me nivelet më të larta të ndotjes së ajrit në botë për sa i përket tre ndotësve të rregulluar: dioksidi i squfurit (SO₂), pluhuri dhe oksidet e azotit (NOX).⁷ Në një raport të fundit të Bankwatch⁸ evidentohet se në vitin 2022, emetimet e SO₂ nga njësitë e qymyrit të BiH ishin tetë herë më të larta se norma, ndërsa emetimet e pluhurit nga TEC Gacko ishin dymbëdhjetë

1 Vendi nuk ka burimet e veta për nxjerrjen e gazit natyror dhe e importon nga Rusia të gjithë gazin që përdor. Megjithatë, gazi përbën vetëm 3% të totalit të energjisë së vendit, pasi gazi natyror përdoret vetëm në disa qytete për qëllime ngrohjeje. Shih [Bosnjë dhe Hercegovinë - Energjia \(trade.gov\)](https://bosnia-herzegovina-trade.org/)

2 <https://oec.world/en/profile/country/bih>

3 Bosnje dhe Hercegovina - Eksportet, Importet dhe Partnerët Tregtarë | OEC - Observatori i Kompleksitetit Ekonomik (Observatory of Economic Complexity)

4 Javno Pareduzeće - kompani publike

5 Mješovit Holding - Pronësi e përbashkët (Ndërmarrja Elektrike e Republikës Srpska e Shoqërisë Aksionare të Trebinjës) <https://ers.ba/organizational-chart/>

6 Bosnjë dhe Hercegovinë - Energjia

7 https://www.complyorclose.org/wp-content/uploads/2023/06/2023_06_28_Comply-or-close.pdf

8 [2023_06_28_Comply-or-close.pdf \(complyorclose.org\)](https://www.complyorclose.org/wp-content/uploads/2023/06/2023_06_28_Comply-or-close.pdf)

herë mbi mesataren.

Ashtu si të gjitha vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor, BiH pritet të kalojë nga qymyri tek energjia e rinovueshme dhe të miratojë e përdorë praktika më të qëndrueshme mjedisore teksa punon drejt integritit në BE. Megjithatë, ashtu si fqinjët e saj, BiH varet shumë tek energjia hidrike në krahasim me energjinë e erës dhe atë diellore⁹ dhe mbetet në fazat e hershme të përgatitjes për t'u përafruar me politikat energjetike dhe klimatike të BE-së. Nga ana tjetër, ajo përballet me vështirësi në arritjen e marrëveshjes për një tubacion mbarëkombëtar gazi që do të lidhë vendin me rajonin dhe do të mundësojë furnizimin me gaz jo-rus.¹⁰

Në raportin e tij të vitit 2022 për BiH, Komisioni Evropian i kërkoi vendit të miratojë legjislacionin për energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe angazhimet e marra në Samitin e Sofjes 2020 mbi Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Ai këshilloi gjithashtu BiH të finalizojë dhe miratojë planin kombëtar të energjisë dhe klimës (NECP) 2021-2030.

Në vitin 2022, Republika Srpska (RS) miratoi ligjet e reja për burimet e rinovueshme të energjisë dhe bashkëprodhimin efikas të energjisë, ndërsa Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës (FBiH) miratoi ligje të reja për energjinë elektrike, energjinë dhe rregullimin e aktiviteteve të energjisë (në pritje të miratimit të parlamenti i entitetit). Drafti NECP aktualisht është duke u shqyrtuar nga Komuniteti i Energjisë,¹¹ ndërsa Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme (Irena) prezantoi kohët e fundit Vlerësimin e Gatishmërisë së Bosnjë dhe Hercegovinës (RRA) për Energjinë e Rinovueshme, vlerësim në të cilin propozohen një sërë rekomandimesh për të përshpejtuar tranzicionin e energjisë së këtij vendi.¹² Kjo parashikon një reduktim të emetimeve të gazeve serrë me 41.21% nga nivelet e vitit 1990, një përqindje e energjisë së rinovueshme prej 43.62%, futjen e modelit të Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të Bashkimit Evropian dhe mbylljen e projekteve të reja të termocentraleve me qymyr.

⁹ [Sektori i energjisë në Bosnje dhe Hercegovinë - Bankwatch](#)

¹⁰ Intervistë e Ministrisë Federale të Energjisë, Minerave dhe Industrisë (online, 07/06/2023)

¹¹ <https://www.energetika.net/eu/novice/energy-policy/bih-forsees-necp-adoption-byend-2023---official>

¹² <https://www.energetika.net/eu/novice/energy-policy/irena-presents-steps-to-speedup-bih's-energy-transi>

II. Padija e publikut dhe pasojat e tmerrshme të ndotjes

Pavarësisht se përdor kryesisht gazin natyror për ngrohje, Sarajeva është qyteti më i ndotur në Evropë, veçanërisht gjatë muajve të dimrit. Të dhënat¹³ tregojnë se në janar 2023, leximet ditore të grimcave të imëta në ajër (të matura si grimca (PM) 2.5) shkuan mbi $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$ gjatë 16 ditëve – disa herë më të larta se ajo që Organizata Botërore e Shëndetësisë e konsideron të sigurt. Në të njëjtin muaj, prania e grimcave u rrit mbi $100 \mu\text{g}/\text{m}^3$ për pesë ditë. Po ashtu, BiH është e pesta në botë për nivelin më të lartë të vdekshmërisë nga ndotja e ajrit.¹⁴ Shifra të tilla e bëjnë tranzicionin energjetik të BiH një çështje për jete a vdekje.

Por publiku duket se nuk është në dijeni se sa e rëndë është situata. Sondazhi i kryer në kuadër të këtij projekti zbulon se çështjet mjedisore dhe siguria e energjisë janë shqetësime më pak të rëndësishme për qytetarët e BiH sesa vështirësitë ekonomike dhe korrupsioni. Vetëm kur u pyetën në mënyrë specifike për shqetësimet mjedisore, të anketuarit e identifikuan ndotjen e ajrit si një problem shumë serioz. Një aktor i intervistuar për këtë studim madje pohoi se “pavarësisht shfrytëzimit të qymyrit, Ballkani Perëndimor nuk është veçse një ndotës minimal e matur për frymë”.

Report_WB6 Situata e energjisë në Bosnje dhe Hercegovinë 040423.

Qytetarët e Bosnje dhe Hercegovinës janë më shumë të shqetësuar për korrupsionin, pasuar nga vështirësitë ekonomike.

Which of these problems is more concerning to you personally?

■ All answers
[MULTIPLE RESPONSE]

■ The first answer

		Demography [all answers - %]												
		Male [N = 463]	Female [N = 517]	18-29 [N = 207]	30-59 [N = 532]	60+ [N = 281]	Lower education [N = 531]	Medium education [N = 141]	Higher education [N = 141]	Federation [N = 520]	Republika Srpska [N = 366]	District Brčko [N = 24]	Urban [N = 430]	Rural [N = 570]
Economic hardship	27% 	55	51	57	52	52	53	53	53	53	53	49	53	53
Ukraine War	9% 	24	24	21	25	25	23	27	16	22	29	25	23	25
Corruption	33% 	57	58	50	58	63	57	56	65	59	53	79	58	57
Possible conflict in the Balkans	7% 	21	22	22	23	19	17	24	23	22	22	4	23	20
Environmental degradation	3% 	13	12	12	14	11	14	11	14	11	15	17	10	15
Energy crisis	7% 	24	20	21	22	22	22	23	19	19	26	29	26	19
Climate change	5% 	14	15	12	16	12	14	13	18	13	17	4	14	15
Weak democracy	3% 	14	11	15	12	11	10	14	12	11	14	8	12	12
Something else	3% 	7	5	7	6	5	6	6	6	7	5	8	6	6
DK/NA	2% 	2	2	5	1	3	4	2	0	3	1	0	2	3

¹³ <https://www.hrw.org/news/2023/02/08/time-tackle-bosnia-and-herzegovinas-toxic-air#:~:text=The%20country%20has%20the%20fifth,increased%20respiratory%20and%20cardiovascular%20conditions.>

¹⁴ <https://www.hrw.org/news/2022/08/29/bosnia-and-herzegovina-deadly-air-pollutionkilling-thousands>


Sondazhi tregon gjithashtu se 73% e qytetarëve mendojnë se BiH duhet të marrë energji nga burimet e rinovueshme, ndërsa 74% e qytetarëve mbështesin fuqishëm investimet në burimet e brendshme të rinovueshme të energjisë.

Report_WB6 Situata e energjisë në Bosnje dhe Hercegovinë
040423.


Pjesa më e madhe e qytetarëve mendojnë se Bosnje dhe Hercegovina duhet të marrin energjinë nga energjia e rinovueshme

... një numër mjaft i madh i atyre me arsim të mesëm krahasuar me ata me më pak vite arsim dhe banorët e zonave urbane në krahasim me ato të zonave rurale.

In your opinion, our country should, by 2050, mainly receive its energy from:




By demography [%]




Rritja e investimeve te burimet vendase të energjisë së rinovueshme do të ishte zgjedhja më e mirë për krizën energjetike për 74% të qytetarëve

In response to the energy crisis, should your country invest more in...?



By demography [%]



Kur u pyetën se kujt ia hidhnin fajin, të anketuarit në BiH mendojnë se BE (22%) dhe Rusia (21%) "ndihmojnë më së shumti në rritjen e përdorimit të lëndëve djegëse fosile". Konkretisht, 18% në Federatë, 30% në RS dhe 8% në distriktin e Brçkos besojnë se BE është fajtori kryesor, ndërsa për Rusinë 10% në Federatë, 40% në RS dhe 33% në distriktin Brčko e shohin si faktorin kryesor. Kështu,

pikëpamjet e njerëzve duken se varen nga gjeografia dhe afiniteti i entitetit të tyre me aktorë të ndryshëm të jashtëm, gjë që përcakton llojin e informacionit që u ofrohet dhe përhapja e tij në publik.

III. Dominimi i lëndëve djegëse fosile

Varësia e BiH nga qymyri – që përbën pothuajse 70% të konsumit të saj total të energjisë – pritet të vazhdojë në vitet e ardhshme. Në vend janë pesë termocentrale, të gjitha të lidhura me minierat që ndodhen aty pranë. Dy më të mëdhenjtë, TPP Tuzla dhe TPP Kakanj, ndodhen në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës dhe të dyja operohen nga Elektroprivreda FBiH. Tre të tjerët janë në Republikën Srpska: TPP Ugljevik dhe TPP Gacko që drejtohen nga Elektroprivreda Republike Srpske dhe TC Stanari dhe miniera ngjitur që janë në pronësi private të grupit të biznesit të energjisë elektrike Energy Financing Team (EFT), pronari i shumicës së aksioneve të të cilit është Familja Hamović (Vuk).

Blloku 4 i Tuzlës dhe Blloku 5 i Kakanjit duhej të ishin mbyllur në vitin 2022 sipas Traktatit TKE, por qeveria dhe parlamenti i FBiH miratuan një zgjatje të paligjshme të jetës së tyre, duke shkaktuar hapjen e një procedure nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në tetor 2022 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.¹⁵ Ekspertët e konsultuar për këtë projekt thanë se Tuzla dhe Kakanj ka të ngjarë të vazhdojnë të funksionojnë deri në vitin 2040 ose edhe më tej. Përveç kësaj, planet famëkeqe të BiH për të zgjeruar ose ndërtuar termocentrale të reja me qymyr i kanë ndërlikuar më shumë problemet që dalin nga termocentralet e trashëguara. Për shembull, projektet për të zgjeruar Tuzla 7 dhe Ugljevik III janë të dyja të lidhura me kompanitë kineze dhe mbeten të parealizuar pavarësisht kontratave të nënshkruara që datojnë një dekadë më parë.¹⁶ Ndërkohë që Kina është burimi dominues i financimit për “energjinë e pistë” në BiH, vitin e kaluar u raportua se edhe kompania çeke Witkowitz ishte e interesuar për projektin Gacko II, i cili ka qenë në gjendje të fjetur prej disa vitesh.

¹⁵ <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/the-energy-sector-in-bosnia-and-herzegovinahttps://www.energy-community.org/news/Energy-Community-News/2022/10/28.html>

¹⁶ <https://balkans.aljazeera.net/news/economy/2021/9/30/kinesko-ne-uvertira-u-kraj-projekta-od-750-miliona-eura>

IV. Nxitja nga Kina drejt qymyrit dhe efektet e saj në sektorin e energjisë

Projekti energjetik më i diskutueshëm deri më sot është zgjerimi i TEC-it të Tuzlës. Investitori në këtë projekt është Kompania Elektrike e Bosnjë dhe Hercegovinës (EPBiH) duke përdorur kredi nga një bankë kineze. Pjesëmarrësit në tryezën e ekspertëve pohuan se marrëveshja për zgjerimin e TEC-it të Tuzlës u arrit nga Zlatko Lagumxhija dhe Mirza Kušljugić në vitin 2014. I pari ishte Ministër i Punëve të Jashtme, ndërsa ky i fundit ishte anëtar i Partisë së tij Socialdemokrate. U referuan edhe lidhje të tjera politike, përfshirë rolin e presidentit serb Aleksandar Vučić në këtë projekt dhe në projekte të tjera energjetike. Të gjithë aktorët e intervistuar ranë dakord që ndërtimi i TEC Bllokut 7 të Tuzlës nuk do të ndodhë.¹⁷

Në nëntor 2017, pas disa vitesh pa asnjë progres, Banka e Eksport-Importit të Kinës ra dakord të jepte një kredi prej 613 milionë eurosh për ndërtimin e TEC-it 7 nga një konsorcium i përbërë nga tre kompani kineze. Disa muaj më vonë, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i kërkoi qeverisë së FBiH të rezervojë në garantimin e huas, sepse ajo nuk ishte në përputhje me ligjin e BE-së dhe për këtë arsye ishte e paligjshme.¹⁸ Kompania amerikane General Electric (një nënkontraktor që mbulonte prodhimin e një turbine dhe gjeneratori 450 MW) u tërhoq nga projekti pasi nuk arriti të merrte miratimin e nevojshëm. Ky rezultat solli kosto të konsiderueshme për vendin¹⁹, përfshirë këtu humbjen e 230 milionë markave të konvertueshme që ishin shpenzuar tashmë për projektin. Në vitin 2021, Kina njoftoi tërheqjen e saj nga investimet në minierat e qymyrit dhe për prodhimin e energjisë në Ballkanin Perëndimor.²⁰ Me përjashtim të pjesshëm të Kolubara 2 në Serbi, ka të ngjarë që epoka e projekteve të mëdha të qymyrit të financuara nga Kina në rajon të kenë përfunduar tashmë.

Edhe pse shpesh referohen si “investime kineze”, aktorët e interesuar nga Kina janë zakonisht kreditorë dhe kontraktorë në kontrata individuale projektesh energjetike (PPN – projektim, prokurim, ndërtim) me kompanitë kineze. Miniera dhe termocentrali TEC Stanari, i vetmi termocentral plotësisht privat në BiH, u ndërtua nga Korporata Kineze Dongfang Electric (sipas një kontrate PPN me pronarin EFT) me një kredi prej 350 milionë euro nga Korporata e Bankës

¹⁷ <https://www.intellinews.com/bosnia-likely-to-end-deal-with-chinese-consortium-ontuzla-7-coal-plant-construction-296071/?source=bosnia-and-herzegovina>

¹⁸ https://bankwatch.org/press_release/bosnia-herzegovina-federal-parliament-guarantees-chinese-coal-plant-loan-in-contempt-of-eu-law

¹⁹ <https://www.slobodnaevropa.org/a/blok7-tuzla-termoelektrana-kinezi/31958831.html>

²⁰ <https://6yka.com/kolumne/kina-obustavlja-projekte-na-ugalj-republika-srpska-neodustaje-od-termoelektrana>

Kineze për Zhvillim.²¹ Pjesëmarrësit e tryezës sonë pohuan se qeveria e RS ishte e përfshirë drejtpërdrejt në këtë projekt duke ndryshuar rregulloren për Transferimin e Kontratës së Koncesionit dhe të Drejtat e Pronësisë së Koncesionarëve. Pjesëmarrësit sugjeruan se Grupi EFT kishte marrë trajtim preferencial për koncesione ose kontrata të tjera në RS. Çështja u hetua nga Qendra për Gazetari Hulumtuese (CIN)²² si dhe nga gjykatat²³ në disa raste në fillim të viteve 2000, por EFT u pastrua nga çdo akuzë penale. Megjithatë, marrëdhëniet e kompanisë mbeten në fokus të mosbesimit të publikut.

Në rastin e Ugljevik, termocentrali i dytë më ndotës me qymyr në Evropë,²⁴ u konstatuan parregullsi me procedurat kontraktuale, të cilat ngrenë dyshime për korrupsion.²⁵ Në vitin 2022, Qendra për Mjedisin Banjaluka (CZZS) – një nga organizatat më aktive në mbrojtjen e çështjeve mjedisore në vend – paditi qeverinë e RS²⁶ për dhënien e lejes mjedisore për për TEC i ri Ugljevik III tek Comsar Energy (në pronësi të miliardërit rus Rašid Serdarov).

Pjesëmarrësit në tryezë shpjeguan se përfshirja e aktorëve kinezë nxit spekulime dhe mosbesim (mes qytetarëve, qeverisë dhe kompanive) për këto projekte. Mungesa e qartësisë në lidhje me përfitimet për entitetet e BiH dhe mungesa e transparencës në ndarjen e kontratave ka të ngjarë të jenë një arsye pse pjesëmarrësit në tryezë pohuan se këto kontrata janë pjesë e rrjeteve klienteliste të ndihmuara nga partitë politike për të financuar interesat e tyre.

Kompanitë shtetërore kineze priren të angazhohen me kompanitë vendase në Ballkanin Perëndimor në projekte me qymyr dhe i anashkalojnë mekanizmat e shqyrtimit dhe miratimit. Kjo ngre pyetjen “nëse përpjekjet e Kinës për projekte të reja me bazë qymyrguri në Ballkanin Perëndimor kontribuojnë drejtpërdrejt në minimin e shtetit ligjor”.²⁷ Siç e tha edhe një ekspert: “Ne nuk e dimë se çfarë shkruhet në kontratën me kinezët, atyre u mungon transparenca. Unë nuk kam folur me kinezët.”²⁸

Të njëjtin mendim evidentoi edhe një ekspert tjetër i lartë nga Zenica, i cili hoqi një paralele me privatizimin e ArcelorMittal Zenica, në pronësi të Mittal Steel që nga viti 2004: “Bizneset e industrisë së rëndë janë konsumatorë të mëdhenj të energjisë. Ata të gjithë kanë trajektore dhe probleme të ngjashme – ndotjen (filtrat nuk përdoren edhe nëse ekzistojnë). ArcelorMittal Zenica nuk i përmbushi kurrë premtimet e bëra për komunitetin.”²⁹

21 <https://china.aiddata.org/projects/42189/>

22 https://www.cin.ba/energopotencijal/en/istrazivacke_price/javno-dobro-za-kineskikredit.php

23 <https://www.theguardian.com/uk/2005/jul/23/freedomofinformation.politics>

24 <https://www.env-health.org/wp-content/uploads/2019/02/Chronic-Coal-Pollutionreport.pdf> (faqe 15)

25 <https://www.slobodnaevropa.org/a/bih-termoelektrana-ugljevnik/31354624.html>

26 <https://www.slobodnaevropa.org/a/ekolozi-tuzba-ministarstvo-rs-dozvolatermoelektrana/31943674.html>

27 <https://www.slobodnaevropa.org/a/bih-termoelektrana-ugljevnik/31354624.html>

28 Intervistë me një aktivist OJQ dhe ekspert mjedisor në Tuzla (29/05/2023)

29 Ekspert mjedisor (intervistë online, 06/06/2023)

V. Kina synon të dominojë edhe sektorin e energjisë së rinovueshme

Tranzicioni i gjelbër i BiH është bërë përherë e më tërheqës për aktorët e huaj. Për shembull, në mars 2022, gjatë një takimi me Grupin e Miqësisë për Azinë të Asamblesë Parlamentare të BiH-së, ambasadori kinez njoftoi se Pekini do të nisë investime të reja në energjinë e rinovueshme në vend, përkatësisht në hidrocentrale dhe centrale me erë. Fillimisht pritej të kishte projekte me miliarda euro, por deri më tani financimi mbetet nën tre milionë marka të konvertueshme.

Grupi EFT tashmë ka marrë koncesion nga qeveria e RS për ndërtimin e HEC Ulog në Neretva, përsëri me Sinohydro Corporation Limited si kontraktor. Aktualisht, tre kompani kineze po luftojnë për një kontratë PPN për HEC Buk Bijela në Lumin Drina,³⁰ që është një bashkëpunim mes EPRS dhe EPS. Projekti kundërshtohet nga autoritetet në FBiH, të cilët e shohin atë si një kërcënim për lumin.

Në dhjetor 2021, filloi ndërtimi i fermës së erës Ivovik që ndodhet në Hercegovinë midis Tomislavgrad dhe Livno. Kjo është ferma më e madhe e erës në BiH. Dy kompani shtetërore kineze – China National Technical Import & Export Corporation dhe Powerchina Resources – planifikojnë të investojnë 130 milionë euro në projekt, që është investimi më i madh në energjinë e rinovueshme në vend.³¹ Paralelisht, në vitin 2021, kompania serbe Energy Financing Team (EFT) nënshkroi një kontratë PPN³² me Dongfang Electric International Corporation³³ (DEC) të Kinës për të ndërtuar një termocentral me energji diellore Bileća 60 MW në Hercegovinën Lindore (Republika Srpska), afër Trebinjës.³⁴ Korporata DEC liston vetëm projektet e energjisë së pastër, të cilat portretizojnë imazhin e një kompanie plotësisht të përkushtuar ndaj tranzicionit të gjelbër dhe një të ardhmeje të qëndrueshme.³⁵

Statusi i tranzicionit energjetik u diskutua edhe me ekspertë në tryezën e rrumbullakët në Tuzla. Ata treguan se gjatë dekadave të fundit, kompani private nga Sllovenia, Kroacia dhe Austria, ndër të tjera, kanë marrë koncesione të

30 <https://serbia-energy.eu/republika-srpska-three-chinese-companies-are-fighting-for-the-largest-hydroelectric-project/>

31 <https://n1info.ba/english/news/chinese-companies-building-biggest-wind-park-in-bosnia/#:~:text=The%20investment%20by%20China%20National,hours%20of%20electricity%20per%20year.>

32 Projektim, Prokurim, Ndërtim

33 Studiuesit tentuan të kontaktonin me kompaninë për të bërë një intervistë, por as numri i telefonit dhe as emaili në uebsajtin e tyre nuk duket se ishin funksionalë.

34 <https://www.reuters.com/business/energy/eft-chinas-dec-sign-49-mln-deal-build-solar-plant-bosnia-2021-12-03/>

35 <https://www.dongfang.com.cn/index.htm>

rëndësishme dhe subvencione në mënyrë disproporcionale të larta (10-15%) për të shfrytëzuar hidrocentralet në vend në krahasim me prodhimin e tyre. Për më tepër, hulumtimi tregon se projekte të tilla, përfshirë ato të fituara së fundi, janë miratuar pa marrë parasysh shumë ndikimin e tyre në mjedis.³⁶ Si rezultat, në vende si Fojnica³⁷, Kruščica³⁸, Neretvica³⁹ dhe Buna⁴⁰ publiku ka treguar rezistencë të fortë.⁴¹ Në vitin 2022, fillimisht Dhoma e Ulët dhe më pas Dhoma e Lartë e Parlamentit të FBiH miratuan ndryshime në Ligjin e Energjisë Elektrike të entitetit të tyre për të ndaluar ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël deri në 10 MWh për shkak të ndikimit të tyre negativ në mjedis.

VI. Siguria e energjisë po blen paqe sociale

Sektori i banimit është përgjegjës për pjesën më të madhe të konsumit total të energjisë në BiH.⁴² Ligjet për burimet e rinovueshme mbeten thelbësore në këtë kontekst.⁴³ Një model i energjisë së rinovueshme është përdorimi i stacioneve të energjisë fotovoltaike në pronësi private (PPS) prej 200 kW, të cilat prodhojnë energjinë e tyre dhe janë të lidhur me një sistem energjie fotovoltaike (sistemi PV).⁴⁴ Në gusht 2023 Parlamenti i FBiH-së miratoi disa ligjesh gjithëpërfshirëse për energjinë. Këto ligje rregullojnë burimet e rinovueshme dhe bashkëgjenerimin si dhe ofrojnë potencialin për rritjen e mbështetjes për prodhimin e energjisë diellore.⁴⁵

Arsyetimi i ofruar nga të intervistuarit për shfrytëzimin e lëndëve djegëse fosile, veçanërisht nga prodhuesit shtetërorë të energjisë, është siguria energjetike, e cila nga ana tjetër garanton paqen ekonomike dhe sociale. Ja çfarë thotë një i intervistuar: “Ne në BiH nuk e ndjemë krizën energjetike. Lëndët djegëse fosile na dhanë siguri sociale. Çmimet e energjisë elektrike mbetën të njëjta pavarësisht krizës energjetike të shkaktuar nga lufta në Ukrainë.”⁴⁶

Duke qenë se çmimet e energjisë rregullohen nga agjencitë shtetërore (FERK,

36 Studimi BiEPAG

37 [Stop Persecution - Two illegal dams and villagers battling the year round \(stop-persecution.org\)](#)

38 [A Balkan Dam Boom Imperils Europe's Wildest Rivers - Yale E360](#)

39 [After protests, and as the result of an on-going legal battle, two small hydropower plants on the Neretvica River are cancelled \(rewild.org\)](#)

40 <https://antikorupcija.info/bunski-kanali-konacno-zasticeni/>

41 Studimi BiEPAG

42 <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/the-energy-sector-in-bosnia-and-herzegovina>

43 <https://eu.boell.org/en/2022/03/07/bosnia-and-herzegovina-dismantling-monopolies-green-transition>

44 Intervistë me përfaqësuesin e EPBiH (30/05/2023)

45 <https://solaro.net/usvojen-set-reformskih-energetskih-zakona-u-fbih/>

46 Po aty.

DERK dhe REERS), çmimet e energjisë elektrike mund të mbahen artificialisht të ulëta. Prodhimi i energjisë nga qymyri shpesh paraqitet edhe si një mundësi punësimi. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët folën për varësinë ekonomike të komuniteteve vendore nga termocentralet dhe minierat në një kohë kur papunësia e të rinjve në Tuzla është në nivelin 70%. Sipas një të intervistuari, TEC-i i Stanarit punëson rreth 1,000 njerëz, të cilët rrezikojnë të humbasin vendin e punës nëse mbyllet ky termocentral mbyllet. Kompania EFT kontribuon edhe në zhvillimin e komunitetit vendor sipas faqes së tyre në internet.⁴⁷

Diskutimet në tryezën e rrumbullakët nxorën në pah se edhe Bashkia dhe Kantoni i Tuzlës janë të nxitur të mbështesin projektet që kanë të bëjnë me zgjerimin e TEC-it duke marrë ngrohje (uji i ngrohtë është një nënprodukt i prodhimit të energjisë elektrike). Pjesëmarrësit folën për 22,000 familje që janë aktualisht të lidhura me sistemin e ngrohjes në distancë të furnizuar nga ky TEC. Rreth 20,000 nuk janë ende të lidhur, por shpresojnë të jenë (pjesë të Tuzlës, Lukavac dhe Živinice).

Fatkeqësisht, është anashkaluar ndikimi në shëndetin e komuniteteve, ku pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët raportuan vdekje të heshtura në shumë familje dhe mungesë investimesh në shëndetin publik për njerëzit që jetojnë pranë TEC-it të Tuzlës. Madje ka edhe më keq: ekspertët shpjeguan se disa TEC-e të tjerë përdorin qymyr kafe të cilësisë së dobët (i nxjerrë në Mrkonjić Grad), i cili eksportohet edhe në Serbi. Kjo ka vlerë kalorifike më të ulët, por një koeficient ndotës më të madh.

Si përgjigje, kundërshtimi nga shoqatat dhe organizatat vendase dhe ato ndërkombëtare po rritet.⁴⁸ Që nga viti 2013, Qendra për Mjedis nga Banja Luka dhe Qendra për Ekologji dhe Energji nga Tuzla kanë zhvilluar një fushatë duke përdorur sloganin "Stop energjive të pista - e ardhmja është e rinovueshme." Fushata synon të rrisë ndërgjegjësim për gjendjen shqetësuese të mjedisit në BiH dhe sistemin e paqëndrueshëm energjetik të vendit.

Kështu, ndotja, degradimi i mjedisit dhe zhgënjimi popullor po shpërfillen gjerësisht nga politikanët në BiH. Nga ana tjetër, liberalizimi i pabarabartë dhe i ngadalshëm i tregut energjetik të vendit është në kundërshtim me kërkesat e bëra si pjesë e procesit të integritit evropian për harmonizimin e politikës së energjisë dhe klimës.

⁴⁷ <https://www.eft-group.net/new-page-1>

⁴⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=KYfd8xiDwvc>

VII. A mund ta mbrojnë vetveten dhe burimet e saj natyrore Bosnje Hercegovina?

Të marrë së bashku, këto gjetje sugjerojnë se aktorët e huaj janë më shumë një simptomë sesa shkak i tranzicionit të ngadalshëm të energjisë në BiH. Motivimi i tyre kryesor është të mos ushtrojnë ndikim politik në BiH. Përkundrazi, ata vijnë në vend për shkak të bollëkut të burimeve natyrore, infrastrukturës së mirëzhvilluar dhe impianteve të prodhimit si dhe për të gjeneruar fitime. Ata nuk investojnë për të marrë përgjegjësinë për projektet apo për prodhimin e energjisë, por thjesht për të siguruar koncesione dhe për të arkëtuar fitime sa më shumë dhe sa më shpejt para se të hidhen në një marrëveshje të re pa përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale.

Në një mjedis të tillë mundësues, aktorët vendas janë të përgatitur të anashkalojnë efektet negative të përfshirjes së tyre në projektet energjetike të komunitetave dhe vendi në përgjithësi. Kështu, aktorët e huaj bëjnë si të duan në BiH sepse e kanë këtë mundësi – sepse udhëheqësit politikë kombëtarë e bëjnë të mundur një gjë të tillë dhe sepse shoqëria civile dhe popullata e përgjithshme nuk mund ta luftojnë atë në mënyrë efektive. Pasojat afatshkurtra të kësaj papërgjegjshmërie politike janë negative, por pasojat afatgjata do të jenë të tmerrshme.

Deri tani, zbatimi i reformës ka qenë i ndërlikuar për shkak të shpërndarjes së kompetencave në fushën e energjisë në nivel shtetëror, entiteti dhe kantoni.⁴⁹ Duke qenë se çdo entitet ka ligjet e veta të veçanta, strukturat e veta organizative dhe rrjetet e veta të kontrollit të cilësisë, dhe meqenëse ka pak koordinim mes niveleve të ndryshme të qeverisjes, menaxhimi më efektiv i situatës është bërë mjaft i vështirë.⁵⁰ Prandaj BE-ja duhet të insistojë, për shembull, që BiH të krijojë një organ kombëtar mjedisor. Po ashtu, BE duhet të nxisë zgjidhje të brendshme për sistemin aktualisht të ndërlikuar dhe jofunksional të qeverisjes në vend.

49 Shih edhe <https://www.dw.com/en/coal-and-corruption-impede-rollout-of-clean-energy-in-bosnia/a-62161285> dhe <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Bosnia%20and%20Herzegovina%20Report%202022.pdf>.

50 [Bosnia and Herzegovina: Deadly Air Pollution Killing Thousands | Human Rights Watch \(hrw.org\)](https://www.hrw.org/report/2022/10/12/bosnia-and-herzegovina-deadly-air-pollution-killing-thousands)

Rruga përpara drejt vitit 2030 dhe më tej

- > Për të filluar ndryshimin e rrjedhës dhe për të përfituar nga transformimi i sektorit global të energjisë drejt emetimit zero deri në vitin 2050, BiH fillimisht ka nevojë për korniza ligjore gjithëpërfshirëse që rregullojnë çdo aspekt të procesit: burimet e rinovueshme, ruajtjen e energjisë në bateri, hidrogjenin dhe hidrocentralet, përdorimin dhe ruajtjen e sekuestrimit të karbonit, tregtinë e karbonit, taksën e karbonit, automjetet elektrike, shpërndarjen/transmisionin e energjisë, efikasitetin e energjisë, qytetet inteligjente, mikro-rrjetet dhe projektet e gazit në energji, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së.
- > Bosnje dhe Hercegovina duhet të marrin më shumë presion dhe mbështetje financiare dhe ekspertizë nga procesi i integritetit për të arritur përputhshmërinë. Disa të intervistuar cituan mungesën e interesit të BE-së në sektorin e energjisë, ndërsa të tjerë thanë se Delegacioni i BE-së ishte aktiv dhe mbështetës i qeverive dhe departamenteve që merren me energjinë. Në aspektin pozitiv, Sarajeva po punon për t'u bërë neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2035 si pjesë e nismës Qytete me Emetime Zero të BE-së. Është një nga tre qytetet në Ballkanin Perëndimor që do të jetë pjesë e nismës, së bashku me Podgoricën dhe Elbasanin. Nisma ka një përfshirje të gjerë dhe dialog me qytetarët.
- > Aktorët politikë në vend janë fajtorët kryesorë kur bëhet fjalë për problemet në sektorin e energjisë. Kjo nënvizon nevojën për veprime më konkrete për të luftuar korrupsionin (shqetësimi i dytë më i rëndësishëm në sondazhin tonë me qytetarët në rajon), rrjetet klienteliste dhe praktikatat e paligjshme.
- > Për fluksin e investimeve nga aktorë të huaj, veçanërisht të Kinës, duhen mekanizma të konsoliduar kontrolli dhe verifikimit, masa ndëshkuese (p.sh., gjoha për ndotësit apo për shkelje kontrate) dhe bashkërendimin e kuadrit ligjor në të gjitha nivelet e qeverisjes, së bashku me diversifikimin strategjik të financave dhe kapitalit shtetëror.
- > Në këtë kuptim, përpjekjet politike dhe diplomatike duhet të harmonizohen me shoqërinë civile dhe mediat e pavarura. Këta aktorë luajnë një rol kyç në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Nga ana tjetër, ata mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit tek popullata në përgjithësi për sa i përket sfidave të ndryshme por edhe përgjegjësi të vetë njerëzve (p.sh., kursimin e energjisë elektrike, termoizolimin e shtëpive dhe përdorimit të pompave me

ngrohje), duke mobilizuar mbështetjen e publikut për reformat

> Rekomandimi i shoqërisë civile është për investime të vazhdueshme për edukimin e publikut të gjerë rreth çështjeve mjedisore, klimës dhe energjisë, mbështetur me financim nga BE dhe BiH.

Rreth Nesh

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the Balkans - EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga studiues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Koordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihic, Richard Grieveson, Donika Emiri, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent koordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

<https://biepag.eu>

Kontakt: MILENA STEFANOVIĆ, Drejtore Programi,
milena.stefanovic@balkanfund.org

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha gjithëpërfshirëse - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritetit në BE. Fondacioni mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platforma ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

www.balkanfund.org

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive,
aleksandra.tomanic@balkanfund.org

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore

<http://csees.uni-graz.at/>

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER,
Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore,
florian.bieber@uni-graz.at

Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Evropian për Klimën. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim është e autorit(ve). Fondacioni Evropian i Klimës nuk mund të jetë përgjegjës për përdorimet që mund t'i bëhen informacioneve që jepen ose shprehen në këtë studim. Fondi Evropian për Ballkanin 2023.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.

